



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 577 Prot.

Roskovec, më 24, 08 2021

VENDIM

NR. 66 .DATË 23 . 08 .2021

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN KORRIK 2021”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 21.07.2021, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Korrik 2021.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al
Nr. 5148 Prot.

Roskovec, më 21.07.2021

Procesverbal Nr.8

-I mbajtur sot, date 21.07.2021, ora 11, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së muajit Maj dhe Qershor 2021 të Këshillit Bashkiak.
3. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Qershor 2021.
4. Për miratimin e fushates së partneritetit të Keshillit të Bashkise me qytetaret.
5. Për shfuqizimin e Vendimit të Keshillit të Komunes Kurjan Nr.3 date 24.01.2012.
6. Për dhenien e titullit “ Qytetar nderi”.
7. Për miratimin e modelit të certifikates për dhenien e titullit “Qytetar Nderi”.
8. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 11⁰⁰

Keshilltaret prezent: A.Kola, E.Çepele, L.Hoxha, L.Goga, B.Çobo, B.Kuka, D.Hoxha, K.Hyska, G.Hoxha, A.Hazizi, V.Bakaj, V.Dogani, A.Sheme, H.Beqiraj, M.Sufka.

Keshilltaret që mungojnë : Viktor Mata, Rrapi Hazizi, Tajane Kuka, Valbona Stani, Bajame Toska.

Prezent nga bashkia: Kryetarja e bashkise, Nenkryetari M.Goga, Dr.Juridike, P/Arsimit dhe Kultures, P/Z/Ndihmes Ekonomike.

Me plotesimin e kuorumit , kryetari i keshillit hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 15 keshilltare. Kryetari fillon mbledhjen, sqaron një ndryshim në kalimin e pikave të rendit të ditës, pikën 6 dhe 7 do të kalojmë të parat për arsye se kryetares i duhet të levizet. Hidhet në votim ky ndryshim i renditjes së pikave të rendit të ditës dhe miratohet unanimitisht me 15 vota pro.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Hidhet në votim rendi i ditës me ndryshimin e bere si më sipër dhe miratohet unanimitisht me 15 vota pro.

2. Për miratimin e modelit të certifikates për dhenien e titullit “Qytetar Nderi”.

P/Arsimit dhe Kultures sqaron modelin e certifikates që do të jepet për titullin “Qytetar Nderi”. Kryetarja sqaron se duhet të miratohet njëher modelin e certifikates në parim. Në zgjedhjen e një model që nuk ka kosto, do të japim një titull moral, i jemi referuar modelit që ka Korca, si e cila do të jetë certifikata dhe stema me logon e bashkise. Ky model do të jetë për ne vazhdimi kur të

jepen tituj nderi.Bujari-biem ndesh ne me Korcen si model?Do vendosim elementet tona-sqaron kryetarja.Nuk ka vlere financiare,eshte titull moral.Leksi-ky ishte modeli me i mire dhe me pak kosto?Kryetarja-ka nje komision qe eshte marr me perzgjedhjen e modelit te certifikates.Bujari-logon qe kemi ne sot,eshte e ligjeruar per ta ndryshuar?Kryetarja-logoja eshte miratuar me VKM.Modeli ka disa element metalik ne perberje dhe nuk kushton,nese me vone do kete propozim edhe ne buxhet,keto elemente mund te behen edhe prej ari ose argjendi ne varesi.Pra ky modeli yne nuk ka vlere monetare por vetem vlere morale.Hidhet ne votim projekti per miratimin e modelit te certifikates sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 15 vota pro.

3.Per dhenien e titullit “Qytetar Nderi”

Kryetarja sqaron se kur te behet ceremonia do ti jepet edhe Sabri Vlingës te cilet ju e keni miratuar. Ka nje procedure ligjore per dhenien e titullit “Qytetar Nderi”. Per dhenien e titullit duhet mar edhe konfirmimi per figuren e personit nese eshte i paster si figure apo jo. Institucioni perkates jep informacionin per figuren e secilit emer. Emrat e propozuar per titull nderi jane: Jonus Plaku, Vladimir Agalliu, Izet Hoxha, Rrapo Kuka, Rrap Plaka, Jashar Cepele,Izet Agaci,Harrila Goga, Fecorr Rama, Xhuljeta Kulla dhe motivacionet per secilin prej tyre. Per tre prej tyre na ka ardhur pergjigje nga institucioni qe jane te paster, njeri prej tyre nuk eshte i paster na kane thene ne menyre kofidenciale ata te institucionit por sot do mblidhen dhe do kthejne pergjigje. Bujari:- per znj. Xhuljeta Kulla pash qe vetem 6 muaj ka jetuar ne Strum, i takon ti japim titull nderi? Kryetarja sqaron se titulli jepet per motivacione te ndryshme dhe kontributin qe ata kane dhene ne komunitet, te gjithë keta persona kane nje lidhje me zonen tone. Leksi:- kush eshte ne komision per dhenien e titullit qytetar nderi? Dr. Juridike sqaron emrat e komisionit. Leksi- mos te kemi konflikt interesi. Aleksander:- per z. Izet Hoxha ne vitin 1995-2002 ka punuar si mesues matematike te shkolla 8-vjecare ne Suk 2, propozon si motivacion. Nuk ka pyetje. Hidhet ne votim dhenia e titullit “Qytetar Nderi” per Z.Jonus Plaku,Z.Vladimir Agalliu,Z.Izet Hoxha,Z.Rrapo Kuka,Z.Jashar Cepele,Z.Izet Agaci,Z.Harrilla Goga,Z.Fecorr Rama,Znj.Xhuljeta Kulla sipas motivacionit perkates per secilin prej tyre dhe miratohen unanimisht me 15 vota pro dhenia e titullit “Qytetar Nderi” i Bashkise Roskovec. Per secilin prej tyre do kete vendim me vete. Dhenia e titullit per z.Rrap Plaka nuk u shqyrtua per arsye te shkreses se ardhur nga Autoriteti per Informimin mbi Dokumentet e ish-sigurimit te shtetit.

Kryetarja sqaron ne lidhje me festen e 24 Korrikut, sqaron axhenden 3ditore te festes sipas diteve perkatese. Festa fillon me date 22 ,dhe vazhdon deri ne daten 24, do te kete aktivitete nga me te ndryshmet sipas axhendes.Kryetarja u sqaron ne lidhje me udhetimet qe po organizohen, jeni te mirepritur, eshte me shpenzimet e veta tuaja,merni informacion tek sekretarja ime. Ka nje kerkes nga nenkryetari dhe kryetari i keshillit per nje udhetim vetem me keshillin brenda Shqiperise.

Vjollca:- falenderim nga ana e banoreve te fshatit Mbers per rrugen e varrezave qe shtruan. Elmazi:- per parkimin e makinave perpara bashkise , te sistemohen.Maksit- te sjelli Arjan Faskon ne mbledhje ne lidhje me ankesat. Leksi pyet ne lidhje trojet e braktisura te cilat jane prone private , Genci- per vendosjen e barrierave ne rruge, Leksi- per unazen perendimore.

4. Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se muajit Maj dhe Qershor 2021 te Keshillit Bashkiak. Hidhet ne votim procesverbalet e mbledhjes se muajit Maj dhe Qershor dhe miratohen unanimisht me 15 vota pro.

5.Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-30 Qershor 2021.

Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 15 vota pro.

6.Per miratimin e fushates se partneritetit te Keshillit te Bashkise me qytetaret.

Sekretarja e Keshillit sqaron projektin.Sqaron se ka te bej me formalizimin e gjithe punes se keshillit te cilen ne e kemi ngritur ne praktike,per ngritjen e urave te komunikimit me qytetaret.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimitisht me 15 vota pro.

7.Per shfuqizimin e Vendimit te Keshillit te Komunes Kurjan Nr.3 date 24.01.2012

Nenkryetari sqaron projektin e shfuqizimit te VKB Kurjan per shbllokimin e rruges se zene nga z.Veli Patozi.Nga gjithe dokumentacioni qe kemi kjo rruge eshte kanal dhe jo rruge,ne keto kushte keshilli duhet te bej shfuqizimin e atij vendimi.Elmazi-zotria ne fjale e ka perfituar token me ligjin 7501 apo e ka zaptuar?Cfare pretendon zotria ne fjale,ku e ka arsyen e pretendimit te tij?Dr.Juridike-ne i referohemi gjithmone dokumentacionit.Sandri-harta ka qene e njejte edhe atehere kur e ka kaluar komuna Kurjan?Pergjigja eshte po.Sandri-po si e kane kaluar?Delina sqaron se ju vetem do shfuqizoni vendimin e ish komunes Kurjan.Alketi-zotria plotesohet me siperfaqen e tokes qe ka marr nga shteti?Delina-do hapet rruga ekzistuese.Maksi-skemi pune me siperfaqen,kemi vetem shfuqizimin e vendimit te keshillit Kurjan.Kryetari i keshillit propozon qe kete projekt ta lem per ne mbledhjen tjeter,te ngrejme edhe nje komision nga keshilli per ta verifikuar ne terren.Elmazi-ne duhet ta degjojme palen,pastaj te marrim vendim.Delina-shfuqizimi i ketij vendimi behet se eshte i paligjshem,me dokumentacion ajo eshte kanal.Pra sipas Aktit te Marrjes se Tokes ne Pronesi (AMTP) nuk eshte percaktuar rruge kalimi,por kanal.Keshilltaret bien dakort ta kalojne ne kete mbledhje pas sqarimit te bere nga Dr.Juridike.Hidhet ne votim shfuqizimi i Vendimit te Keshillit te Komunes Kurjan Nr.3 date 24.01.2012 dhe miratohet me 13 vota pro dhe 2 vota abstenim M.Sufka dhe A.Sheme.Miratohet me shumice votash.

8.Diskutime dhe komente te qytetareve.

Nuk ka diskutime.Kryetari mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini

Kryetar

Kadri Hyska